



Pranimi / Dorëzimi Priljepe / Priljepe Receipt / Delivery	06-05-2021	1	viti god year
Organ / Shpresa Organ / Shpresa Org / Unit	Nr. Prot No. Prot Prot No	Shtesa / Prilog Appendix	Sasia Kolicuma Quantity
SKRMBHAK	2267/2021		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.176/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Arben Mehmeti-anëtarë dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbaitëses, kanë shqyrtuar ankesën e datës 23.03.2021 me numër A.nr.176/2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë: Rruga "Fadil Ferati", pa nr. në Dardani, në Komunë të Prizrenit, kundër Vendimit me Nr.01-112-36554 të datës 09.03.2021 për transferim të përkohshëm, të Kryetarit të Komunës së Prizrenit, në çështjen juridike "transferim i përkohshëm", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 06.05.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pa bazuar ankesa me numër Anr.176/2021 e datës 23.03.2021, e parashtruar nga ankuesi

II. MBETET në fuqi Vendimit me Nr.01-112-36554 të datës 09.03.2021 për transferim të përkohshëm, i Kryetarit të Komunës së Prizrenit.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Komunën e Prizrenit, në vendin e punës: "Zyrtar për Bashkëpunim me DKA", sipas Ndryshim dhe Plotësimit e akt emërimit të datës 17.10.2018, me datë 09.03.2021 Kryetari i Komunës së Prizrenit ka nxjerrë Vendimin me Nr.01-112-36554, me të cilin ankuesin e transferon përkohësisht në pozitë "Zyrtar për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme", në Sektorin e Tatimit në Pronës, në Drejtorinë Komunale për Buxhet dhe Financa në Komunë të Prizrenit.

Kundër Vendimit me Nr.01-112-36554 të datës 09.03.2021 të Kryetarit të Komunës së Prizrenit, ankuesi më datë 23.03.2021 ka parashtruar ankesë me numër Anr.176/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave procedurale dhe materiale, dhe vërtetimit jo të plote dhe të drejte të gjendjes faktike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 29.03.2021, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Komuna e Prizrenit. Këshilli, më datë 12.04.2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Komuna e Prizrenit, përmes formës elektronike (E-mailit) së bashku me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin Ankesave për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesë e datës 23.03.2021 me numër Anr.176/2021, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me nr. protokollit 1325/21; Vendimi me Nr.01-112-36554 i datës 09.03.2021 i Kryetarit të Komunës së Prizrenit, për transferim të përkohshëm të ankuesit; Vendimi Nr. I/12425 i datës 17.07.2019, për invalid të luftës, lëshuar nga Qeveria e Kosovës-Zyra për Çështje të Kategorive të Dala nga Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës; Vendimi i datës 14.03.2018, lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenës Sociale; Raport mjekësor i datës 15.03.2021 lëshuar nga mjeku, specialist i neuropsikiatrisë dhe specialist i ortopedisë dhe traumatologjisë, prej 1-2 faqe; Udhëzim mjekësor për konsultim, nga ortopedia; Përgjigje në ankesë E-mail i datës 12.04.2021; shpresë nga përgjigja në ankesë e datës 07.04.2021, nga Menaxheri i personelit i Komunës së Prizrenit; Ndryshim dhe Plotësim i Akte emërimit, nr. 01-112-154452 i datës 17.10.2018; Akte emërimit nr. 01-112-20409 i datës 01.03.2017; Akte emërimit nr. 01-112-10572 i datës 02.03.2018; Titulli i vendit të punës Zyrtar i të hyrave financiare me përshkrim të detyrave të punës i datës 04.12.2012, prej 1-4 faqe, (e përsëritur 1/3 faqe); Fletë kthese e datës 11.03.2021, metë cilin ankuesi ka pranuar Vendimin e datës 09.03.2021, për transferim të përkohshëm; Vendimi me Nr.01-112-154452 i datës 17.10.2018 i Kryetarit të Komunës së Prizrenit, për transferim të përhershëm të ankuesit, në vendin e punës: "Zyrtar për Bashkëpunim me DKA"; Kërkesë për prova shtesë e datës 26.04.2021 përmes E-mailit të zyrtares së lartë për bashkëpunim profesional; Përgjigje në E-mail, e datës 29.04.2021, të bashkangjitur kërkesën e datës 09.03.2021 nga Drejtoria për Ekonomi dhe Financa; përshkrimi i detyrave të punës "Zyrtar për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme"; Plani i punës për Drejtorin për Ekonomi dhe Financa, për vitin 2021.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka vërtetuar se ankesa e ankuesit *shtë e pa bazuar, sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji ka konstatuar se ankuesi sipas Ndryshim dhe Plotësimit e akte emërimit të datës 17.10.2018 mbanë pozitë: "Zyrtar për Bashkëpunim me DKA", me datë 09.03.2021 Kryetari i Komunës së Prizrenit ka nxjerrë Vendimin me Nr.01-112-36554 me të cilin ankuesi është transferuar përkohshëm, me kërkesë të datës 09.03.2021 të Drejtorisë për Ekonomi dhe Financa, për shkak të pamundësisë së shpalljes së konkursit për tri pozita të lira me rastin e pensionimit të nëpunësve civil në Sektorin e Tatimit në Pronë, dhe duke pasur ngecje në regjistrimin dhe verifikimin e pronave kërkon mundësinë e transferimit të nëpunësve civil nga drejtorit e tjera.

Kolegji për Shqyrtimin dhe vendosjen e Ankesave, konstaton se ankuesi kundër Vendimit me Nr.01-112-36554 të datës 09.03.2021 për transferim të përkohshëm, ka parashtruar ankesë me datë 23.03.2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se pozita në të cilën është transferuar është në kundërshtim me nivelin e shkallës së invalidëve të UÇK-së shkalla e invaliditetit prej 40% sipas Vendimit Nr.I/12425 të datës 17.07.2019 invalid i luftës së UÇK-së, si dhe për shkak të gjendjes shëndetësore pozita e transferuar i duhet me qenë në teren në ecje të vazhdueshme, nuk mund e përballoj sipas raportit mjekësor të datës 15.03.2021 nga mjeku Ortoped me diagnozë të përcaktuar si: "pacienti nuk mund të përballoj ecjen në distanca të largëta".

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka analizuar pretendime ankimore të ankuesit lidhur me atë se pozita në të cilën është transferuar nuk përkon me gjendjen shëndetësore të tij, në bazë të shkallës së invaliditetit sipas Vendimit Nr.I/12425 të datës 17.07.2019 invalid i luftës së UÇK-së, konstaton se pretendimet e ankuesit nuk janë të bazuara sepse në bazë të shkallës së invaliditetit të përcaktuar të UÇK-së të drejta dhe benefitet e tij janë të përcaktuara në nenin 9 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 dhe nenin 10 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr. 04/l-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, që përcakton se: "**1. Invalidët e UÇK-së, sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në këtë ligj, realizojnë këto të drejta dhe beneficione:.....1.8. përparësi në punësim në kushte të barabarta të punës**", duke u ndërlidhur me nenin 24 paragrafi 1 i Ligji Nr. 04/l -261 për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ku përcaktohet se: "**E drejta e përparësisë në punësim;1. Veteranët Luftëtar të UÇK-së dhe Pjesëtarët e UÇK- së gëzojnë, në kushte të**

barabarta, të drejtën e përparësisë në punësim, në institucionet dhe në ndërmarrjet e sektorit publik”, që në rastin konkret ankuesi i gëzon të gjitha të drejtat dhe obligimet të barabarta në kushte të barabarta në punësim dhe në marrëdhënien e punës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe vendosjen e Ankesave, bazuar në shkresat e lëndës, përkatësisht Vendimin me Nr.01-112-36554 të datës 09.03.2021 për transferim të përkohshëm, ka konstatuar se transferimi i ankuesit është bërë për interes të institucionit për shkak se pozita *''Zyrtar për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme''*, ka mbet e lire me rastin e pensionimit të nëpunësve në Sektorin e Tatimit në Pronë, andaj me qëllim të menaxhimit të punëve dhe detyrave, për një periudhe në afat të caktuar, ka ardhur deri te transferimi i ankuesit/nëpunësit civil.

Andaj, duke i'u referuar dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht të nenit 52 ku përcaktohet se: *''1. Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori, në këto raste: 1.1. kur është në interes të institucionit, deri në 6 muaj gjatë 2 vjetëve; 1.2. për përmirësimin e rezultateve të vetë nëpunësit, deri në 3 muaj gjatë 2 vjetëve; 1.3. për arsye të përkohshme shëndetësore në bazë të vendimit të komisionit kompetent, sipas ligjit, për aq sa është e nevojshme, sipas vendimit të komisionit përkatës''*, si dhe duke u bazuar në shkresat e lëndës, ku shihet se ankuesi është transferuar nga pozita: *''Zyrtar për Bashkëpunim me DKA''*, në pozitën e punës *''Zyrtar për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme''*, për një periudhe të caktuar kohore, Kolegji vlerëson se pretendimi ankimor i ankuesit është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se pozita e punës *''Zyrtar për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme''*, ku ankuesi është transferua përkohësisht, se gjatë kryerjes së detyrave të punës i duhet që gjatë tërë kohës të jetë në teren dhe në ecje dhe me pamundësinë e realizimit të detyrave të punës dhe çështjes shëndetësore nuk mund ta përballoj të vërtetuara me raport mjekësor të datës 15.03.2021 nga mjeku Ortoped me diagnozë të përcaktuar citon: *''pacienti nuk mund të përballoj ecjen në distanca të largëta''*, në bazë të provave të lëndës është konstatuar se pretendim është i pa qëndrueshëm sepse në përshkrimin e detyrave të punës të bashkangjitur për përgjigjen e provave shtesë të datës 29.04.2021, për pozitën *''Zyrtar për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme''*, del se në përmbajtje të përshkrimit nuk është i përfshirë terreni dhe ecja, si në vijim: *''1. Harton dhe zhvillon planin e punës në pajtim me mbikëqyrësin për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave të njësisë dhe jep rekomandime lidhur me realizimin e këtyre objektivave; 15%; 2. Analizon legjislacionin, politikat dhe procedurat në lëmin e pronave të paluajtshme dhe vlerësimin e tyre dhe rekomandon përmirësimin e proceseve nëse është e nevojshme; 10%; 3. Vlerëson dhe përllogarit vlerën e pronave të paluajtshme sipas kriterëve dhe standardeve të caktuara me legjislacionin në fuqi dhe regjistron në sistemin për menaxhimin e pronave; 20%; 4. Administron sistemin për menaxhimin e tatimit në pronë dhe vlerësimin të pronave të paluajtshme sipas kriterëve dhe standardeve të caktuara me legjislacionin në fuqi; 15%; 5. Përpunon ndryshimet e nxjerra sipas vendimit të komisionit komunal për shqyrtimin e ankesave lidhur me vlerësimin e pronave të paluajtshme; 15%; 6. Pranon dhe analizon kontratat për shitblerjen e pasurisë së patundshme, Hulumton çmimet e objekteve ndërtimore dhe pronave ndërtimore dhe i regjistron në bazën e të dhënave; -10; 7. Përcaktimi i tatimit në pronë të paluajtshme në bazë të vlerësimin të pronës dhe kriterëve, standardeve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi; 15% dhe 8. Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi; 5%*, kështu që pretendimi ankimor i ankuesit në këtë kuptim është i pa bazuar.

Kolegji për Shqyrtimin Ankesave, vlerëson se Kryetari i Komunës së Prizrenit, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr.01-112-36554 të datës 09.03.2021, me të cilin ankuesin e transferon përkohësisht në pozitë *''Zyrtar për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme''*, në Sektorin e Tatimit në Pronë, në Drejtorinë Komunale për Buxhet dhe Financa në Komunë të Prizrenit, për interes të institucionit, ka vepruar në me nenin 52 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, si dhe nenin 4 paragrafin 1 të Rregullores (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.176/2021

Zyler ~~Millaku~~ GOJNOVCI

Zyrtarë e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Vendimi i dërgohet

Ankuesit

Kryetarit të Komunës së Prizrenit;

Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunë të Prizrenit dhe

Arkivit të KPMSHCK-së

